



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDER MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT

Nr. 227/prot
1

Durrës, më 12/05/2026

V E N D I M

NR. 7 DATË 12.05 2026

PËR

**"PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMIN
E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT DOKTORATË, PËR VITIN AKADEMIK 2025-
2026 PRANË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, në shkresën e Rektorit nr. 2383 Prot., datë 28.12.2023 "Mbi përcjelljen e kriterëve të pranimit për Programet e Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor, programet e studimit me karakter profesional 2-vjeçar, për programet e Ciklit të Dytë të Studimeve Master i Shkencave dhe Master Profesional dhe Ciklit të Tretë të Studimeve Doktoratë për vitin akademik 2025-2026 në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", në dakordësi me anëtarët e Departamentit, për sa më sipër Departamenti,

V E N D O S I

1. Përcaktimin e kriterëve të pranimit të studentëve në Programin e Ciklit të Tretë të Studimit Doktoratë në "Shkenca Ekonomike" për vitin akademik 2025-2026 pranë Departamentit të Menaxhimit si më poshtë vijon:
 - 1) Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkenca Ekonomike duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave në fushën e Menaxhimit, Shkencave Ekonomike ose të përafërta me to.
 - 2) Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit (ose diplomë e integruar e nivelit të dytë, DIND) me notë mesatare të lartë.
 - 3) Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një universitet të huaj diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin.
 - 4) Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të Shkencave Ekonomike ose në fusha të përafërta.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDER MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT

- 5) Përparësi do të kenë kandidatet të cilët janë diplomuar në fushën ekonomike dhe biznesit.
- 6) Preferohen kandidatë të cilët shfaqin aftësitë:
 - a. Të menduarit krijues;
 - b. Zhvillimi i sensit kritik lidhur me fushën e kërkimit;
 - c. Lidhjet mes fushave të ndryshme të kërkimit;
 - d. Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
 - e. Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e kërkimit dhe për të propozuar ide të reja në fushën e kërkimit;
- 7) Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin. (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, e ndryshuar). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- 8) Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor, të dakortësuar nga udhëheqësi.
- 9) Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Menaxhim dhe Shkenca Ekonomike të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.
- 10) Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës nga profesorë të cilët njohin eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.
- 11) Kandidati duhet të ketë punë hulumtuese kërkimore shkencore në një nga fushat e Shkencave Ekonomike.
- 12) Kandidati duhet të kenë eksperiencë të paktën 2 (dy) vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një Institucion të Arsimit të Lartë, apo Institucione të kërkimit bazë ose të zbatuar. Përrjashtohen nga ky kriter studentët e ekselencës.

Kritere të veçanta mund të përcaktohen në varësi të kërkesave specifike të projekteve kërkimore.

2. Përcaktimin e metodologjisë së pikëzimit për pranimin e studentëve në Programin e Ciklit të Tretë të Studimit Doktoratë në "Shkenca Ekonomike" për vitin akademik 2025-2026 pranë Departamentit të Menaxhimit si më poshtë vijon:

- a. Diploma e fituar, kriteri (a)
 - i. Bachelor në Menaxhim

(maksimumi 400 pikë)

200 pikë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDER MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT

ii.	Master Shkencor në Menaxhim	200 pikë
iii.	Bachelor, programe të përafërta	150 pikë
iv.	Master Shkencor, programe të përafërta	150 pikë
b.	Nota mesatare, kriteri (b)	<u>(maksimumi 250 pikë)</u>
i.	9.51 – 10.00	250 pikë
ii.	9.01 – 9.50	210 pikë
iii.	8.51 – 9.00	180 pikë
iv.	8.00 – 8.50	150 pikë
c.	Njohuri në gjuhë të huaja, kriteri (e)	<u>(maksimumi 200 pikë)</u>
i.	Më shumë sesa një gjuhë e huaj	200 pikë
ii.	Një gjuhë e huaj	150 pikë
d.	Pjesmarje në konferenca dhe revista shkencore, kriteri (j)	<u>(maksimumi 150 pikë)</u>
i.	Më shumë sesa 2	150 pikë
ii.	Deri në 2	100 pikë

Shënim

- Kandidatët renditen sipas pikëve totale
- Pranimi bëhet sipas kuotave të miratuara

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTUESI I NJËSISË BAZË

Dr. Denada Liça